



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:157107

Datë: 15.04.2024

Numri i dokumentit: 05575045

C-IV-13-0414

Paditës:

Z J nga Klina me vendbanim ne fshatin G, Pejë, përfaqësuar nga av. **M K**, Pejë

Kundër

E paditura:

K.B “Malishgan” – Klinë, të cilën e përfaqëson **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha ” nr. 55, Lakrishtë –Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga gjyqtarët Hajrie Shala kryesuese, Manushe Karaqi dhe Diellza Hoxha, gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me dt.15 prill 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Kërkesa për Masë të Sigurimit, refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Nuk caktohen taksa gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.19.12.2005 paditësi ka parashtruar padi në DHPGJS, ka kërkuar kthimin e tokës së ekspropriuar ne vitin 1965, caktimin e masës së përkohshme dhe ndalimin e privatizimit të KBI “Malishgan” Klinë deri në përfundimin e procedurës gjyqësore.

Dhoma e Posaçme me Aktvendimin SCC-05-0562 të datës 10.10.2006 e ka referuar lëndën Gjykatës Komunale ne Klinë (GJKK).

Paditësi me dt.19.05.2008 ka parashtruar padi ne Gjykatën Komunale në Klinë, e cila ka qenë e drejtuar për Dhomën e Posaçme dhe ka kërkuar kthimin e tokës së ekspropriuar në vitin 1965

dhe caktimin e masës së përkohshme dhe ndalimin e privatizimit të KBI “Malishgan” Klinë deri në përfundimin e procedurës gjyqësore.

Me dt.19.12.2008 Gjykata Komunale në Klinë ka lëshuar Aktvendimin C.nr.292/2006 me të cilin ka ndërprerë procedurën duke u mbështetur në Ligjin e Republikës së Kosovës 03-L-048 lidhur me kompensimin.

Me dt.21.05.2012 Gjykata Komunale në Klinë ka njoftuar DHPGJS lidhur me lëndën C.nr.292/06 dhe i ka dërguar shkresat e lëndës Dhomës së Posaçme si gjykatë kompetente.

Me anë të parashtresës së datës 15.06.2007 AKP ka paraqitur një njoftim Dhomës së Posaçme se likuidimi i Ndërmarrjes KB “Malishgan” Klinë/Klina ka hyre në fuqi nga data 14.05.2007 dhe ka kërkuar ndërprerjen e të gjitha procedurave kundër ndërmarrjes së sipërshënuar të cilat aktualisht janë ose mund të jenë në të ardhme në gjykatë.

Me dt.28 janar 2021, Z J si trashëgimtarë i vetëm Y J ka dorëzuar një parashtresë me të cilën njofton gjykatën se nëna e tij ka vdekur me dt.19.03.2013 dhe tani e tutje ai është trashëgimtarë i saj. Kësaj parashtrese i ka bashkangjitur edhe një kopje të vendimit të trashëgimisë të lëshuar nga Gjykata Komunale e Smederevës me datë 27.11.2013 në mënyrë që të vazhdohet procedura në këtë lëndë.

Me dt.10 shkurt 2021 përfaqësuesi i palës paditëse ushtron parashtresë plotësuese me të cilën thekson se prezanton certifikatën e pronës e datës 09.02.2021 si dhe kopjen e certifikatës së pronës e lëshuar nga njësia kadastrale me numër P-.....

Me dt.12 shkurt 2021 gjykata lëshon një urdhër për AKP-në, ku i kërkon AKP-së sqarim se prona kontestuese 05,94.11 ha, a është e përfshirë në ngastrën kadastrale....

Me dt.25 shkurt 2021, AKP- ja jep përgjigje në urdhër duke theksuar se parashtruesja Zh J ka parashtruar kërkesë në procedurë të likuidimit e cila i është refuzuar nga AL-ja me Vendimin me nr.PEJ172-0008. Në bazë të dokumenteve që i posedojnë, AL-ja thekson se pala i referohet parcelës.... Për më tepër informacion parcela nr.... është parcelizuar dhe tani janë krijuar tri ngastra të reja ..,.... dhe .. në sipërfaqja prej 1600m2 dhe në vitin 2006 me vendim të Gjykatës Komunale në Klinë C.NR.481/05 ka kaluar në emër të personit privat, pjesa e mbetur prej 68697m2 ka kërkesë për interes publik për kompleks sportiv.

Tutje shtoi se Bordi i Drejtorëve të AKP-së (tutje BID), me datë 29 korrik 2020 ka dhënë pëlqimin për lejimin e vazhdimin të projektit ndërtim i fushës ndihmëse të futbollit, në ngastrën kadastrale me nr. ..me sipërfaqe 05,94.11 ha, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore “KBI Malishgan“, me zotimin se Komuna që në momentin e vlerësimit të pronës do të paguaj vlerën sipas nenit 6A par.1 dhe par. 3 të Ligjit të AKP-së. Në vendimin për kthim në pronësi komunale janë edhe parcelat ..dhe...

Me dt.05 mars 2021, me anë të një urdhëri gjykata kërkoi nga Zyra Komunale e Kadastrit të Klinës shënime të historiatit kadastral dhe shënime shtese lidhur me pronën kontestuese.

Me dt.08 mars 2021, paditësi Z J ushtroi një parashtresë me plotësim të provave në padi, respektivisht propozim për dëgjimin e 4 dëshmitarëve lidhur me çështjen në fjalë.

Me dt.29 tetor 2021, paditësi ushtron kërkesë për masën e sigurisë të parcelës nr..., ZK Klinë që është objekt i padisë.

Me dt.03 nëntor 2021, gjykata i dërgon përfaqësuesit të paditësit një urdhër me të cilën kërkon nga ankuesi të bëjë sqarimin se cili do të jetë dëmi i menjëhershëm dhe i pariparueshëm që do të pësonte nëse nuk aprovet kërkesa për Masë të Sigurimit, në pikën e dytë të urdhërit obligon ankuesin që të bëjë pagesën e taksës gjyqësore dhe në fund në pikën tre kërkon nga ankuesi autorizimin e avokatit M K.

Përfaqësuesi i paditësit nuk i është përgjigjur urdhërit të gjykatës në afatin e caktuar nga gjykata, por me dt.07 dhjetor 2021 në gjykatë dorëzon një kërkesë për konsultim me gjykatën në kuptim të sqarimit të rastit në fjalë, andaj gjykata me Aktvendimin e saj nr.C-IV.-13-0414 të dt.25 shkurt 2022, ka vendosur duke e konsideruar Kërkesën për Masë të Sigurisë të tërhequr. I autorizuari i paditësit me dt.15 korrik 2022 në gjykatë ka paraqitur një parashtrësë për precizimin e kërkesëpadisë për shkak të kthimit të pronës, me anë të së cilës ka kërkuar që të aprovet kërkesëpadia dhe të zhvlerësohet Aktvendimi i Seksionit për Ekonomi dhe Financa i Kuvendit Komunal në Klinë nr.04-1218/1 dt.01.03.1966 si dhe ti Kthehet paluajtshmëria në posedim paditësit, parcela me nr..., tokë e klasës së dytë, në sipërfaqe prej 0.78,65 ha, ZK Klinë, e cila figuron në emër të NSH “Malishgan” – Klinë.

Me dt.19 gusht 2022 i autorizuari i paditësit përsëri ka paraqitur një parashtrësë për precizim të kërkesëpadisë, me anë të së cilës ka kërkuar të vërtetohet se paditësi është pronar i ish parcelës kadastrale nr... në sip prej 8.78,65 ha ZK Klinë.

Me anë të parashtrësës së dt.19 qershor 2023, ka bërë dorëzimin e provave materiale Regjistrin e individëve që i janë ekspropriuar paluajtshmëritë në vitin 1965.

Me dt.18 tetor 2023, i autorizuari i paditësit me anë të një parashtrëse ka pohuar se nuk është e vërtetë që parcela ... me vendim gjyqësor ka kaluar në emër të personit privat, derisa parcelat .. dhe..., është e mundshme të kenë kaluar në emër të personave privat. I ka bashkangjitur këto prova: Kopjen e planit nr.6 të dt.24.11.2005, Kopjen e planit të dt.05.06.2015, foto, Certifikatën e pronësisë për parcelën kadastrale.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur seancën gjyqësore të dt.22 nëntor 2023, ku kanë prezantuar përfaqësuesit e palëve ndërgjyqësore.

Me dt.08 dhjetor 2023, i autorizuari i paditësit ka paraqitur në gjykatë Kërkesë për lëshimin e Masës së Përkohshme të Sigurisë, ku ka pohuar se meqenëse AKP ka deklaruar se Bordi i Drejtorëve me dt.19.07.2020 ka dhënë pëlqim për lejen e vazhimit të projektit në interes publik të parcelave..., e në këtë parcelë bënë pjesë edhe parcela e paraardhësit të paditësit ekziston rreziku për dëm të menjëherë dhe të pariparueshëm nëse nuk aprovet masa e sigurimit. Tutje ka kërkuar që të aprovet propozimi për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë në parcelën kadastrale nr.... në sipërfaqe prej 5.94.11 ha ZK Klinë. Propozimit i ka bashkangjitur këto prova: Aktvendimi mbi trashëgiminë i Gjykatës Themelore në Smederevo T.nr.2592/13 dt.27.11.2013, Shpallja në të përditshme Koha Ditore dt.29 shtator 2019.

Gjykata me dt.23 nëntor 2023, ka lëshuar një urdhër përmes të cilit ka kërkuar nga Drejtorati për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë i Komunës së Klinës që ta njoftoj gjykatën lidhur me

shënimet historike kadastrale dhe shënimet e azhurnuara kadastrale për të drejtat e pronës së parcelës kadastrale nr... sipas fletës poseduese nr.... ZK.Klinë.

Me dt.13 dhjetor 2023, e njëjta i është përgjigjur gjykatës ku ka theksuar se në bazë të regjistrimit të ndrrimeve nr.26/1968 ngastrale nr... ZK Klinë, me kulturë arë e klasës së II-të, në sipërfaqe prej 0,78.65 ha, kalon në emër të Kombinati Bujqësor “Malishgan” në bazë të vendimit mbi shpronësimin të Kuvendit të Komunës së Klinës nr.04-8237dt.16.10.1965, duke i bashkangjitur përgjigjes këtë vendim.

E paditura - kundërpropozuesja e masës së sigurisë ka paraqitur përgjigjen e saj e dt.14 mars 2024, ku ka theksuar se e kundërshton propozimin për caktimin e masës së sigurisë, pasi që qëndron plotësisht pas vendimit të AL-së dhe se nuk ekziston asnjë nga kushtet për caktimin e masës.Në përgjigje ka shtuar se ngastrale kadastrale ka kaluar në pronësi private në një sipërfaqe të caktuar dhe një pjesë e sipërfaqes ka mbetur, ndaj të cilës ka kërkesë për kalim të pronësisë në pronësi komunale dhe shpallje për interes publik andaj ka kërkuar që të refuzohet kërkesa për caktimin e urdhërit paraprak – masës së sigurisë.

Arsyetimi Ligjor

Kërkesa për masë të sigurimit është e pabazuar.

Sipas Nenit 61 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, Dhoma e Posaçme mund të nxjerr një masë të sigurimit me kusht që parashtruesi të ofrojë prova të besueshme se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të riparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet si i riparueshëm vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar.

Paditësi i cila kërkon urdhër paraprak gjyqësor duhet të dorëzoj dëshmi të besueshme se:

1. ekziston e drejta, dhe
 2. kjo e drejtë mund të dëmtohet në mënyrë të riparueshme nëse nuk miratohet masa e sigurimit.
- Barra e provës është tek paditësi, kështu që paditësi përveç që duhet të ofroj dëshmi të besueshme se e drejta e rrezikuar ekziston, duhet të ofrojë dëshmi dhe ta bëjë të besueshme faktin se do të shkaktohet dëm i menjëhershëm dhe i riparueshëm, nëse nuk aprovohet kërkesa për masë të sigurimit.

Ekzistimi i së drejtës së pretenduar

Pa paragjykuar zgjidhjen përfundimtare të këtij kontesti, Kolegji vlerëson se paditësi në këtë fazë të procedurës, nuk ka dorëzuar dëshmi të besueshme se ekziston e drejta e pretenduar në favorin e tij. Pretendimet e paditësit se është pronar i parcelës kontestuese nuk qëndrojnë, pasi që sipas certifikatës së pronësisë parcela kadastrale nr.... në sipërfaqe prej 59411 m2 gjendet në pronësi dhe posedim të Kombinatis Bujqësor “Malishgan”, andaj meqenëse paditësi ende nuk e ka bërë të besueshme ekzistimin e të drejtës së pretenduar vetëm pretendimi i tij se është pronar i parcelës kontestuese nuk mund të merret si provë për caktimin e masës së sigurisë.

Dëmi i menjëhershëm

Gjykata vlerëson se nuk është plotësuar as kushti për dëm të menjëhershëm për caktimin e Masës së sigurimit, pasi që paditësi nuk e ka paraqitur ndonjë rrethanë, nga e cila pritët të pësojë ndonjë dëm të menjëhershëm dhe se nuk ka dorëzuar dëshmi të besueshme se kjo e drejtë mund të dëmtohet menjëherë, nëse nuk miratohet kërkesa për masë të sigurimit. Paditësi ka dorëzuar shpalljen e publikuar në të përditshmen “Koha Ditore” dt.19 shtator 2019 mirëpo, kjo nuk mund të merret si bazë për caktimin e masës së sigurisë, pasi që nuk ka asnjë provë me të cilën do të bënte të besueshme, se parcela kadastrale e cila është objekt i këtij kontesti, është në procesin e shitjes ose është dhënë shpallja për shitjen e të njëjtës.

Dëmi i pariparueshëm

Sipas dispozitave ligjore dëmi konsiderohet si i “pariparueshëm” vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar. Në rastin konkret, as kushti për dëm të pariparueshëm, si kusht për tu caktuar masa e sigurimit nuk është plotësuar.

Në këtë rast gjykata ka gjetur se kërkesa e paditësit për Masë të Sigurimit nuk mund të ketë mbështetje në dispozitën e nenit 61 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, prandaj kërkesa si e tillë u refuzua.

Shpenzimet Gjyqësore

Në pajtim me nenin 62.2 të Ligjit të Dhomës së Posaçme (Ligji nr. 06/L-086), paditësi si palë e pasuksesshme do të mbulojë shpenzimet e veta. Pala paditëse e ka paguar taksën gjyqësore për propozim për caktim të masës së përkohshme të sigurisë me dt.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Hajrie Shala, gjyqtare Kryesuese

Manushe Karaqi, gjyqtar

Diellza Hoxha, gjyqtare